



MS-05 2020

02/144



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËSË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës

Nr.02/_____

Datë: 28.02.2020

PROCESVERBAL

i mbledhjes së II-të (e dytë) të rregulltë të Kuvendit Komunal të Malishevës

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -XI- të vitit 2019.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit nr.04/19 datë:10.02.2020 i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2019.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/11 datë:28.01.2020 të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për miratim të draft-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2020.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/24 datë:14.02.2020 të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për miratim të propozim Rregullores për Tatimin në Pronë për vitin 2020.
5. Shqyrtimi i Planit vjetor të Njesisë për Auditimin e Brendshëm në Komunën e Malishevës për vitin 2020.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Komunal të Veprimit për Transparencë për Komunën e Malishevës 2020-2024.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë për Komunikim dhe Informim për Komunën e Malishevës 2020-2024.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës nr.02/19 datë:13.01.2020 të Komitetit për Barazi Gjinore për vitin 2019
9. Të ndryshme.

Mbledhja mbahet me datë 28.02.2020 dhe filloi në ora 10:25 Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 21 asambleistë, drejtorë komunalë, përfaqësuesi i OSBE-së, KFOR-i dhe media.

Rrahim Morina: Pershendetje për të gjithë! E hapi mbledhjen e II-të të rregulltë për këtë vit. Të pranishëm jemi 21 asambleistë dhe po i lexoj emrat e atyre që kanë lajmruar që s'kanë mund të vijnë: Hidajete Mazreku, Kastriot Berisha, Arlind Morina, Behije Sertolli, Faik Zogaj, Dianë Hoti dhe Genc Shurdhaj. Për të tjerët që mungojnë s'kam asnjë informacion siç është Fjoralba Buzhala, Valon Krasniqi, Kajtaz Gashi. Tash veç erdhi Valoni.

Kërkoj që të respektohet Rregullorja e Kuvendit për debatin jashtë rendit të ditës, të cilin e hapi tani.

Luan Kryeziu: Pershendetje për të gjithë! Është mirë që Komisioni për Emërtimin e Rrugëve të punojë sipas rregulloreve dhe ligjeve dhe punën ta bëjnë mbrenda në zyre deri sa raporti i tyre të miratohet në Kuvend e ta merr atë legjimitetin e tij. Në mendia janë dal disa keqpërdorime të këtij komisioni rreth emërimit të rrugëve ende pa ardh raporti. Është mirë që të mos luajmë me emrat e dëshmorëve dhe të atdhetarëve. Është mirë që të mos etiketohen disa figura siç është e kryetarit Limaj që kinëse ai ka qasje në këtë problematikë. Fajtorët për këtë janë të VV sepse e kanë plasur këtë si informatë. Është mirë që ata ta kryejnë punën e vet si komision e mos të njëjloshen emrat e tyre dhe të dëshmorëve.

Sylë Dukolli: Pershendetje për të gjithë! Temën që ngriti Luani është se Ktv-së ju ka plasur kjo informatë si një bukë e papjekur sepse edhe puna nuk ka përfunduar në atë komision dhe gjërat nuk kanë përfunduar ende. Ne jemi duke punuar aty.

Me Valonin në mbledhjen e kaluar kemi pasur një duplikë dhe për të gjithë ata që janë ndjerë të fyer ju kërkoj falje! Është mirë që ne mos ta qesim asnjërin në provë sepse jemi njerëz familjar. Ne ana jonë andej nuk po i marrim shërbimet siç duhet të KEDS-it dhe është mirë që ekzekutivi të shtrojë ndikimin e vet për këtë çështje.

Alban Krasniqi: Për çështjen që ngriti njëri nga parafolësi përgjigjen do ta jep përgjigjen anëtarin ynë në atë komision. Është mirë që njëherë të i merrni të gjitha informacionet e më pas të flisni. Çështja për të cilën do të flas ka të bëjë për shkeljet e shumta që ka bërë drejtori i Urbanizmit dhe gjykimin të tij. Mos ndoshta edhe për këtë ndjeheni keq dhe thoni që janë fyer dëshmorët?! Shqetësim për ju është çdo herë kur përmendet emri i liderit tuaj ne nuk jemi për të përfaqësuar interesat e liderëve por interesat e qytetarëve. Ne çështjen e Blincës e kemi ngritur këtu shumë herë dhe jemi detyruar që ta paraqesim edhe në gjykatë. Ne duhet ta mbrojmë intresin publik në mënyrë unike. Ne mund ta kërkojmë dorëheqjen e drejtorit të Urbanizmit dhe suspendimin e atyre zyrtarëve që janë të përfshirë në këso raste.

Raimonda Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Për çështjet që dot'i ngre unë nuk e di kush mund të përgjigjet sepse nuk është as Kryetari dhe as Nënkryetari. Që 5 muaj është pensionuar zyrtari i Arkivit të Komunës, pse nuk është punsuar aty dikush në mënyrë që të funksionojë arkivi? Pse akoma nuk ka drejtor për Qendren për Punë Sociale e cila është në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë e që po bëhen gati 2 vite?

A është ndërruar tapeti në çerdhën e fëmijëve gjatë renovimit që i është bërë çerdhës në vitin e kaluar?

A janë respektuar kriteret për ndërtimin e polsiave të shtrira në tri hyrjet e qytetit të Malishevës?

Hashim Vrenezi: Pershendetje për të gjithë! Është mirë që mediat t'i lëmë të punojnë të pavarura dhe nuk ka rëndësi se cili grup i ka sjellë por e rëndësishme është se a ekziston një kërkesë e tillë për ndërrimin e emrit të një dëshmori me një person të gjallë.

Shqetësuse janë që po punohen disa punë por po jeshin keq dhe nuk po finalizohen siç dua të di se a është bërë pagesa në tërësi për ndërtimin e parkut në Mrali sepse aty disa punë kanë mbetur gjysë, ka mbetur një shakt i hapur në saj rrugë që dëmton veturat dhe që rrezikon fëmijët?

Shqetësuese është edhe vendimet e gjykatave që po e dëmtojnë buxhetin tonë sidomos në sferën e arsimit ku janë larguar njerëzit pa arsye nga puna. Rasti i tillë është i disa mësimdhënësve të Komitencës që me vendim të gjykatës e dëmtojnë buxhetin për 72,000€ që po presim t'i marrin këto mjete. Këtë çështje ja adresoj Blerimit dhe Kryetarit pse kanë ndodhur këto?

Nebih Bibaj: Pershendetje për të gjithë! Kjo qeveri duket sikur të ishte në ikje, Kryetari, Nënkryetari nuk janë këtu dhe ju iknin përgjegjësi që kanë ndaj qytetarëve dhe anëtarëve të Kuvendit.

Kërkoj nga Kryetari i Komunës që të ushtrojë ndikimin e vet ndj KEDS-it për lagjen "Balaj" në Lladroc sepse energjia është tepër e dobët më zi se para lufte.

Në vendin "Livadhet e gjata" në Drenoc kanalizimet kanë dal mbi sipërfaqën e tokës dhe ju ka kontaminuar ujin e pishëm. E njëta gjendje është edhe në Lladroc që pothuajse çdo mbledhje po e paraqes këtu.

Pengesat në rrugë në qytetin e Malishevës janë të vendosura pa asnjë standard dhe kanë filluar të prishen.

Gjatë fundjavës në Malishevë ka shumë mbeturina rrugëve dhe kërkoj që qyteti të pastrohet më shumë të paktën edhe gjatë vikendeve.

Ilaz Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Luan, e përmende emrin tim që jam pjesë e Komisionit për Emërtimin e rrugëve. E them publikisht që nëse e gjen veç një fjalë që ka dal nga unë rreth punës së këtij Komisioni unë më s'jam pjesë e këtij Kuvendi. Shpifja nuk është e mirë! Nëse nuk jam unë ai që i ka thirr mediat, a je i gatshëm ti të japësh dorëheqje nga Kuvendi?!

Në Komision kam kërkuar që rruga "Hasan Prishtina" dhe "Ukshin Hoti" të hiqen sepse nuk i plotësojnë kushtet për rrugë sepse janë shumë të shkurtëra dhe është turp për ne që një rrugë e vogël me pas një emër të madh siç janë emrat që përmenda. Ka pas propozim nga një anëtar që edhe kjo rrugë me emrin e "Hamëz Jasharit" të jetë me një projekt më të madh dhe kërkesa ka ardh prej lagjës "Limaj" që të zëvendsohet me emrin "Njësi Çeliku" kjo rrugë.

Kur jam opyetur nga mediat unë që: A lejohen emrat ose pseudonimet e njerëzve që janë gjallë? Normalisht që kriteret nuk e lejojnë.

Luan Kryeziu: Ne i dimë çështjet e prapaskenave dhe përdorimit të mekanizmave të ndryshme. Kjo nuk d.m.th që ju Baci Ilaz i keni thirrur mediat, por mund ta angazhosh dikë tjetër për këtë

dhe për këtë mund të mbrohesh. Ju edhe vetë këtu i përmendet disa raste. Nuk lidhet çështja e personit të gjallë me “Njësi Çeliku”, pra është emër që përfshinë një pjesë të ushtrisë dhe që kanë dhënë kontributin në luftë.

Rrahim Morina: Meqenëse isha pjesë e këtij Komisioni edhe më parë ju kujtoj që kjo çështje është diskutuar edhe në Kuvend atëherë. Ky Komision për herë të dytë i shqyrton këto ankesa dhe kjo kërkesë ka qenë kryekëputë e lagjes “Limaj”. Ne kur ta përfundojmë punën në këtë Komision do t’u sjellim raportin dhe aty do t’i shihni disa gjëra.

Ilaz Krasniqi: Luan, nëse edhe tërthorazi del emri im, prap qëndroj prapa fjalëve që të thashë më heret. Edhe mua me ka goditur sepse ne në Komisioni i kemi pasur disa parime për punë.

Alban Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Dua t’i ngris disa çështje pavarësisht që Kryetari dhe Nënkryetari nuk janë këtu edhe pse kanë përgjegjësi ndaj qytetarëve. Çështja e Muzeut të Qytetit dhe Bibliotekës që u bënë një vit dhe nuk kanë rrymë pavarësisht që është folur shumë këtu.

Rrugët e qytetit nuk kanë mirëmbajtje dimërore, pse?

Rruga “Skenderbeu” nuk ka ndriçim publik. Ka shumë rrugë të dëmtuara pothuajse në të gjithë qytetin.

Vendosja e shenjave të komunikacionit nëpër rrugë e cila është në mungesë dhe që po rrezikon sigurinë publike në K. e Malishevës.

Në veb-faqen e Komunës e pashë që Kryetari me drejtorin për Shëndetësi i viziton QMF-në në K. e Malishevës ndër to edhe në Panorë. Për rastësi dje kam qenë edhe unë në Panorë me Komitetin për Shëndetësi por ajo dje ka qenë e mbyllur. QKM-ja në Panorë dhe në Llapçevë nuk funksionojnë.

Komuna e Malishevës nuk përfiton asgjë prej KEDS-it pavarësisht shfrytëzimit të tyre për vendosjen e trafave, shtyllave etj. Ndërsa në daljen e Kjevës ku përfshihen disa fshatra nuk ka shërbim të duhur nga KEDS-i.

Në Lladroc a është për pranimit teknik i labidarit dhe pse nuk ka ndriçim publik?

Valon Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Pasi që jam nip i Bubaveci doja që unë i pari t’ju kërkoj falje Sylë publikisht!

Kam një shqetësim për disa orë mësimi në shkollën fillore “Gjergj Fishta” në Senik. Para disa ditësh mësimdhënësi i Biologjisë Hajrullah Rama pas 40 vitesh punë u pensionua. Kërkoj nga DKA E-ja që të sqarojë punën e këtyre orëve pas pensionimit të mësimdhënësit. Ka shumë reagime nga banorët e këtij fshati për këto orë. Një prej tyre edhe mund t’ju lexojë për mos lejimin e hapjes së konkursit. Ato orë ja kanë dhënë një mësimdhënësi aty pa konkurs.

Arbëreshë Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Pajtohem edhe unë Kryesues që të respektohet Rregullorja sa i përket minutave të foltorës.

Sa i përket Komisionit për Emërtimin e Rrugëve Kryesuesi e di që është shkarkuar ky Komision njëherë pothuajse për arsye të tilla. Ne si Malishevë nuk është mirë që të bëhemi temë e diskutimit nëpër media.

Avdi Morina: Pershendetje për të gjithë! Në mandatin e kaluar kam qenë pjesë e Komisionit për Emërtimin e rrugëve dhe me të vërtetë janë respektuar të gjitha ato rregulla dhe parime. E di saktë që kërkesa e parë që ka ardhur nga ajo lagje që t'i vëhet emri asaj rruge "Njësi Çeliku". Atëherë shumicën e ka pas opozita dhe ja kanë lënë emrin asaj rruge "Hamëz Jashari". Nuk i bënë nder ajo rrugicë 300m një emri aq të madh sa është ky hero. Ky emër është vendosur me tendencë. Të gjithë ata që mundohet që të ngrisin kurtha në fund bien vetë.

Rrahim Morina: Kryetari, Nënkryetari dhe disa nga drejtorët nuk janë këtu. Blerimi paska përgjigje.

Blerim Thaçi: Pershendetje për të gjithë! Ne kemi mbingarkesa me mësimdhënës në arsim dhe kur një arsimtar me mungesë të orëve punon atëherë ne nuk mund të shpallim konkurs kur ai e përfiton të drejtën për ato orë. Raste të tilla ka shumë dhe plotësohen normat aty ku mundet dhe mësimdhësi mund të jetë edhe nga një lokalitet tjetër.

Hashim, ata mësimdhënës që përmendet ju kanë pas kontrata të nënshkruara në mënyrë të rregullta dhe kanë qenë puntorë edhe më heret të asaj shkolle, ndërsa që kanë marrë parë të jashtëligjshme janë puntorët që i ka marrë Agjensioni ata nuk kanë punuar dhe kanë marrë paga. Është kometencë e komunës që vendos për të punësuarit në arsimin parauniversitar. kjo është e rregulluar më ligj.

Rrahim Morina: Kam një informacion për ju që ata që si kanë email adresat te ne t'i sjellin tek asistentja sepse materialet jemi duke i përcjellë përmes E-mail adresave.

Kalojmë në debatin për rendin e ditës. Tri pika të rendi të ditës për shkak që s'ka punuar fotokopja nuk kemi mundur ta sjellim materialin për ju e ato pika janë: 1, 6 dhe 7 e që në email i keni pasur. E hapi debatin për rendin e ditës.

Nebih Bibaj: Kryesues, pasi Rregullorja për Transparencë ka shkuar në MAPL për ligjshmëri propooj që pika e 6 dhe 7 të hiqen nga rendi i ditës sepse kanë të bëjnë me këtë rregullore.

Arbëreshë Krasniqi: Mendoj njëjtë sikur parafolësi që pika e 6-të të shtyhet deri sa të marrim një përgjigje nga MAPL-ja.

Rrahim Morina: Kërkoj që edhe procesverbali të hiqet nga rendi i ditës pasi është i përgatitur por s'kemi mund ta shpërndajmë. Propozimet e Nebihut, Arbëreshës dhe i imi janë që të largohen nga rendi i ditës pikat 1, 6 dhe 7. Kush është për?

Për: 16 (unanimisht)

Me këtë votim unanim hiqen nga rendi i ditës pikat 1, 6 dhe 7.

Atëherë shkojmë në votim për rendin e ditës me ndryshime. Kush është për?

Për: 16 (unanimisht)

Me votim unanim votohet rendi i ditës me ndryshime.

Kalojmë në pikën e 1-rë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit nr.04/19 datë:10.02.2020 i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2019. Drejtori e ka fjalën.

Valon Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Po e paraqes në pika të shkurtëra raportin për vitin 2019. Ky raport është i ndarë në 4 pjesë në hyrje, të hyrat, shpenzimet dhe pjesa e 4-ërt janë shpenzimet kapitale. Ky raport është i përpiluar në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë dhe në bazë të standardeve ndërkombtare të kontabilitetit dhe procedurave të thesarit për të hyrat dhe shpenzimet të cilat kanë ndodhur mbrenda kësaj periudhe. Në bazë të dhënave të prezantuara në tabletat përkatëse në këtë raport rezulton se Komuna e Malishevës ka një buxhet të miratuar nga Kuvendi Komunal për vitin 2019 me shumën 14,392,379.89€ për të gjitha programet dhe nënprogramet. Kur kësaj shume i shtohen bartjet e disa shumave të vogëla të donacioneve të mbetura nga vitet e kaluara në vlerë prej 1,140.354€ të regjistruara në SIMFK del që shuma totale e buxhetit 14,393,520.24€.

Gjithashtu kur kësaj shume i shtohen të hyrat e bartura nga viti nga vitet paraprake 167,243.24€ na jep buxhetin përfundimtar 14,463,281.01€ me gjithë grantin e huamarrjes.

Buxheti i alokuar për vitin 2019 kap vlerën 14,334,833.32€ që d.m.th që shkalla e realizimit të buxhetit në total është 91.1%. Sipas shënimeve të librave të thesarit del që shkalla e shpenzimit të buxhetit të realizuar për këtë vit është 91.05%. Kurse përqindja e tërësishme e buxhetit të shpenzuar në raport me alokimin dhe planifikimin është 90.24%.

Në faqet në vazhdim janë dhënë tabelat e planit të buxhetit realizimi, shpenzimi sipas programeve, sipas burimeve, sipas kategorive ekonomike në mënyrë sintetike dhe analitike për periudhën Janar- Dhjetor 2019.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë.

Hashim Vrenezi: Shqetësuese për mua është ajo që Valoni nuk e qartësoi është suficiti buxhetor i cili është rreth 1,282,000.00€ kjo shqetësuese është edhe për qytetarët dhe më shqetësuese është dashur të jetë edhe për qeverisjen Begaj. Të ikë kjo shumë e të mbesin projektet e parealizuar kjo është paaftësi dhe keqmenaxhim e qeverisë Begaj.

Te të hyrat vetanake, te tabela nr. 4 në faqe 3, është shpalosur që të hyrat vetanake të realizuara janë 872,170.36€ që i bie nëse krahasohet raporti me ato të planifikuara, pra nuk e keni tejkalu pragun e planifikimit. Nëse kësaj ja heqim të hyrat nga trafiku dhe gjobat e gjykatës atëherë i bie që realizimi i të hyrave vetanake ka qenë 79,83%.

Te investimet kapitale të buxhetuara kanë qenë mbi 4.5mil ndërsa të alokura kanë qenë 4,468,000.00€ ndërsa në këtë kategori suficiti buxhetor është mbi 1,200.000.00€, pra ato investime kapitali nuk janë realizuar për shkak të neglizhencës së qeverisë Begaj.

Në faqe 18, te tabela 7 për vendimet gjyqësore janë paguar 74,506.00€, ndërsa në faqe 19 te tabela 7.5 për vendime gjyqësore tek pjesa e investimeve kapitale janë paguar 275,623.54€ e që

në total janë 386,333,00€. Kjo shumë për vendime gjyqësore dhe shuma e suficitit i be që rreth 2mil komuna jonë ka treguar paaftësi të menaxhimit të parasë publike.

Gjithëherë për mua po betet shqetësuese zëri buxhetor shërbime kontraktuese tjera që çdo vit rritet për 100,000.00€ e këto mjete nuk po dihet saktë se ku janë duke shkuar. Na ke premtuar që so ta sjellësh një raport për këtë zë buxhetor por ai kurrë s'ka ardhur këtu.

Pse nuk është blerë automjeti i zjarrëfikësve? 80,000.00€ janë shkuar në suficitit e ju s'e keni blerë këtë automjet.

Nuk është realizuar projekti i rrugës prej rrugës kryesore deri te ura e minitransitit, mirëpo mjetet janë raportuar si të shpenzuara. Pse? Kjo lëndë veç është në krime ekonomike.

Nuk e di pse disa projekte siç janë ato të rrugëve janë 2 vjeçare kur mund të përfundojnë mbrenda 2 javëve. Kjo komunën tonë mund ta ngulfasë dhe mund të ketë një dështim më të madh buxhetor.

Ka shumë projekte të parealizuar e disa të papërfunduara siç janë rrugët, trotuarët, parqet e ndryshme, objekti për shoqiatat e dalura nga lufta, në shëndetësi, kulturë, sport, arsim, çerdhja në Kjevë, etj.

Rrahim Morina: Atëherë shkojmë në pauzën e drekës, kethehmi në ora 13:00!

Pas pauzës së drekës vazhdojmë me debatin për pikën e 1-rë.

Alban Krasniqi: Do të mundohem që mos të diskutoj për ato që foli parafolësi sepse ai foli me argumente.

Realizimi i buxhetit për investimet kapitale 71.43% e ku një 1,282,000.00€ kanë shkuar suficit e ku me dhjetëra projekte që janë votuar këtu nuk janë realizuar fare nga qeverisja Begaj. kjo edhe mund t'na gëzoj sepse duke i parë aferat korruptive së baku ajo shumë ka shpëtuar.

Ka një informacion që edhe këto mjetet tjera që janë tek shpenzimet kapitale ndonëse shkruhen që janë të shpenzuara, pjesa dërrmuese nuk janë shpenzuar fare sepse janë projekte që nuk kanë filluar të zbatohen.

Sa mjete nga të hyrat vetanake janë teprice e që kanë qenë të dedikuara për këto projekte? Në këto mjete duhet ti dedikojmë për ato projekte që ju keni dështuar e që janë prioritare.

Te investimet kapitale është një shumë e madhe 275,000.00€ ne kemi kërkuar që sa e sa një listë me të gjitha vendimet gjyqësore gjatë vitit 2019 emër për emër e rast për rast. E njëjta vlenë edhe për shërbimet tjera kontraktuese siç e përmendi edhe Hashimi.

Tek shpenzimet kapitale për disa shërbime dhe projekte ato nuk janë realizuar fare e që po bëhen 2 herë shpenzime se ato projekte po kryhen në vitin tjetër. Për këtë në formë rekomandimesh ju kemi drejtur si Kuvend edhe Qeverisë Komunale. Drejtor, mbi çfarë baze i keni lejuar mjetet që të shkojnë për këtë qëllim e ky qëllim nuk është realizuar?

Drejtor, ju nuk na keni informuar për borxhet që ka Komuna për vitin 2017, 2018 dhe për vitin 2019. Ne jemi Asamble Komunale e votojmë buxhetin dhe jemi përgjegjës për orientimin buxhetor, prandaj duhet t'i dimë edhe këto infomacione. Për këto borxhe kërkoj përsëri një listë për këtë.

Alban Mazreku: Po filloj për ndërtimin e rrugës prej rrugës kryesore në drejti të urës së minitransitit, për 2 vjet kjo rrugë është e planifikuar dhe që 2 herë ndahet buxhet për të e në praktikë as nuk është i filluar si projekt, mirëpo edhe në 2018 edhe për 2019 mjetet nga të hyrat vetanake janë shpenzuar 90% dhe nga granti qeveritar 50%. Ku kanë shkuar këto mjete? Rregullimi i parkut të Gurbardhit, mjetet nga granti qeveritar janë të shpenzuara 60% e aty as që ka filluar të punohet.

Sa i përketë aparatave digjital në shtëpinë e shëndetit janë vendosur por këtu në raport mjetet kanë tepruar sepse shpenzimet janë 0:0.

Vendosja e anshensorit në QKMF në vlerë 20,000.00€, anshensori nuk është vendos, pse?

Aparati i mamografisë të planifikuara kanë qenë 22,000.00€ pjesa nga granti qeveritar është shpenzuar, mirëpo nuk është blerë aparati i mamografisë.

Për rregullimin e oborrit dhe fushës sportive për shkollën "Ibrahim Mazreku" në raport thuhet që nga granti qeveritar janë të shpenzuara 99.99%, mirëpo në shkollë nuk ka asgjë të rregulluar. Ku kanë shkuar këto mjete?

Ndërtimi i Çerdhës në Malishevë 82% e mejteve janë të shpenzuara, por Çerdhe tjetër në Malishevë nuk ka. Ku janë mjetet?

Hidajete Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Sa i përketë të hyrave Janar-Dhjetor 2019 që 4 herë kemi diskutuar për këtë por përgjigje adekuate nuk kemi marrë asnjëherë.

Pse me shku gjithë ato mjete suficit, kjo është si pasojë e menaxhimit të dobët të këtijë buxheti. Për parkun "Adem Jashari" kanë qenë të planifikuara 25,000.00€, por aty nuk është punuar fare. Sqarona këtë drejtor.

Në çdo pikë për buxhetin e kam përmendur apratin e mamografisë e që është kërkesë e shumë grave edhe pse këtë e kemi planifikuar me buxhetin, aparati nuk është blerë veç janë shpenzuar 6,000.00€ nga ky planifikim. Ku kanë shkuar këto mjete?

Te shpenzimet për vendimet gjyqësore, cilat janë ato vendime, ku qëndron puna që po na shkojnë gjithë ato para?

Trajnime në fushën e arsimit. Drejtor, kush është trajnuar, në çfarë cilësie? Ku kanë shkuar këto para?

Furnizimi me ushqim dhe pije, e që nuk janë dreka e darka zyrtare. A jë për çerdhën e famijëve? Paisje tjera, çdo herë kërkoj çfarë janë këto paisje tjera, specifikonejeni drejtor.

Sadije Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Të hyrat vetanake për periudhën Janar-Dhjetor 2019 kanë shënuar një rritje dhe kjo ka ndikuar që të rritet buxheti i komunës dhe me këtë tregohet një përformacë e mirë. Kemi një ngritje të të hyrave nga tatimi në pronë krahasuar me vitin 2018. Shpenzimet për këtë vit tek kategoria e mallërave dhe shërbimeve konsideroj që qeveria i ka ulë shpenzimet sidomos te udhëtimet mbrenda dhe jashtë vendi si dhe shpenzimet e telefonisë mobile. Shqetësuese për mua është shpenzimet për vendimet e gjykatave dhe mos realizimi i projekteve të planifikuara.

Arbëreshë Krasniqi: Ne e kemi diskutuar këtë raport dhe kemi edhe ne ato vërejtjet dhe sugjerimet tona. Disa nga projektet që s'kanë mund të realizohen janë si rezultat i procedurave ligjore dhe Zyrës së Prokurimit.

E përgëzoj drejtorin për këtë raport të përgatitur mirë dhe të detajuar përmes tabelave! E vetmja vërejtje e imja është që të gjitha ato projekte që kryhen të punohen e të kryhen ashtu siç duhet dhe të kenë mbikëqyrje të rreptë.

Alban, sa i përketë çështjes së Sallës së Sporteve në Drenoc dhe vonesës së saj për ndërim e ka një emër dhe ajo është Asambleja Komunale e Malishevës dhe ka bërë një lokacion që nuk është i përshtatshëm dhe i duhuri për lokalitetin.

Rrahim Morina: Do të flas edhe unë për këtë pikë të rendit të ditës. Të gjithë e diskutuam 1 mil e disa Euro që qeverisë i kanë shkuar në suficit e kjo është një paaftësi e tyre për menaxhimin e parasë publike. Pra qytetarë këto mjete kanë humbur dhe nuk ka asnjë justifikim për këtë sepse të gjitha projektet kanë qenë të planifikuara mirë dhe s'ka pasur vonesa të procedurave. Dikush duhet të jep përgjegjësi për këtë. Uroj që kjo kurrë të mos përsëritet në Komunën e Malishevës. Drejtor, cilat projekte kanë dështuar për shkak të kësaj shumë që ka shkuar suficit?

Drejtor, kërkoj sqarime për shkollën e Gurbardhit që 2 herë është tenderuar dhe të dyja herat e ka fituar tenderin e njëjta kompanie që ka qenë shumë më shtrenjët se kompanitë tjera. A ka mundësi ai dokumentacion me ardh në Kuvend?

Alban Mazreku: Sa i përketë Sallës së Sporteve për Drenoc Arbëreshë, unë së bashku me Kryesuesin kemi qenë në një takim me ministrin e Kulturës dhe ata kanë thënë se Komuna e Malishevës asnjëherë nuk e kanë sjellë planin ashtu siç kanë kërkuar. Ne si Asamble e kemi kryer punën tonë me vendimet që kemi marr këtu.

Avdi Morina: Ky raport pasqyron gjendjen reale dhe faktike të buxhetit të K. së Malishevës pavarësisht punëve që janë kryer. Meqë ka ndodh që një shumë e madhe të shkojë suficit nuk mundet ta bartë barrën vetëm qeveria komunale, por bashkëfajtorë e këtij procesi është ka pasur mundësi me anë të disa kërkesave që mjetet të ridestinohen për disa projekte tjera por shumë herë ju kërkesat tona ju nuk i keni përkrahë.

Pajtohem plotësisht edhe unë që të kenë mbikëqyrje sa më të shumtë projektet.

Rrahim Morina: Avdi, ne nuk jemi fajtorë për dështimin e qeverisë Begaj. Ne kemi instituar që të kryhen projektet e planifikuara. Kryetari vitin e kaluar e ka nxjerr një vendim për bartjen e mjeteve për t'i paguar jaranat e vet.

Arbëreshë Krasniqi: Kryesues është shumë e rëndë kur ti thua që: "Kryetari ka nxjerr vendim për t'i paguar jaranat e vet". Ju duhet të mbani përgjegjësi për këtë. Nëse ai ka bërë pagesa ka bërë për kompanitë e kontraktuara për punë të ndryshme për projekte të ndryshme. Kryesues, ju duhet të flisni me qetësi dhe të jeni model për ne, e jo të bëni shpifje të ndryshme. Duhet të keni kujdes për disa fjalë e jo masandej të kërkonit falje.

Rrahim Morina: Arbëreshë, për këtë kurrë nuk do të kërkoj falje sepse Kryetari nuk ka pas të drejtë që ta merr atë vendim për bartjen e mjeteve.

Sadije Krasniqi: Kryesues, e kemi diskutuar çështjen e Sallës së Sporteve për Drenoc sa e sa herë dhe fare s'ka pas nevojë që situatë të vije siç është deri më tani. Mbrapshtë e keni nis këtë çështje dhe mbrapshtë jeni duke e vazhduar. Këtu nuk ka punë që po e bëni në emër të qytetarëve, por po i bëni në emër të interesave të juaja personale. Nuk është mirë ashtu siç e keni për situatën e Sallës së Sporteve për Drenoc. Aq më keq Kryesues, po dilni në foltore dhe po akuzoni qeverinë e cila nuk është përgjegjëse për këtë situatë. Është mirë që t'i merrni ju si opozitë përsipër gabimet dhe shantazhet e juaja që po i bëni. Është mirë që t'ju kërkon falje qytetarëve të Drenocit dhe të gjithë Komunës së Malishevës që shkakun juaj nuk është realizuar ky projekt.

Rrahim Morina: Sadije, bëju më parimore, e sinqertë dhe mos shpif! Vendimi i Kryesisë së fshatit Drenoc ka qenë për atje, dhe ne kemi vendosur ashtu.

Alban Krasniqi: E nderuar ja një rast, e ka votuar Kuvendi Sallën e Sporteve në Astrazub, jo veç opozita dhe ajo është duke u ndërtuar pavarësisht cilësisë. Kuvendi e ka votuar buxhetin, jo për disa por për të gjitha projektet. Rastin e Drenocit e dini të gjithë e nuk po dua të hyj në atë histori se çfarë duket shumë e ultë për ta diskutuar. Pavarësisht përçarjes së banorëve ajo sallë është prap në Drenoc dhe për Drenocin. Nuk e di pse qeverisja komunale nuk e ka realizuar këtë projekt. Me detaje kam trajtuar ato dokumente.

Rrahim Morina: Drejtori e ka fjalën për përgjigje.

Valon Mazreku: Pothuajse të gjithë diskutuesit kanë folur për çështje të njëta dhe përgjigjet mund t'i jap për temat e diskutuara.

E thash që buxheti është shpenzuar 90.24% që nënkupton që pjesa e tjetër e buxhetit nuk është shpenzuar.

Hashim, të hyrat vetanake kanë qenë të planifikuara në bazë të vendimit të Kuvendit sepse buxheti miratohet këtu. Këtu përfshihen edhe të hyrat nga gjykata dhe gjrobat. Llogarit të arkushme janë prej tri burimeve, të taksuara dhe ato tatimore.

Sa i përket shpenzimeve të gjykatave mundemi që t'i nxjerrim vendimet në detaje dhe cili është përfituesi. Këtë e di avokati i komunës.

Te shërbimet tjera kontraktuese disa herë e kam shpjeguar që aty hyjnë ato aktivitete për të cilat nuk ka kod ekonomik adekuatë prej kategorisë mallëra dhe shërbime dhe shërbimet tjera i fusim në këtë kategori. Këtu hyjnë pagesa për administratën, trustin, kontratat mbi vepër, materialin higjienik etj.

Automjeti për zjarrfikësit është blerë me rihapjen e tenderit sepse njëherë është anuluar, por fatura ka ardhur pas datës 24 dhe unë s'ka mund ta ekzekutoj pagesën.

Renovimi i objektit të Komunës nga Kuvendi janë ndarë 50,000.00€ dhe i kemi përfituar edhe 50,000.00€ nga granti i performancës dhe vlera e kontratës për këtë reonovim ka qenë afërsisht 88,000.00€ dhe në dorën tonë si drejtori nuk është pranimit teknik.

Parku në Marali është projekt i papërfunduar në tërësi dhe nuk ka pranim teknik, pagesa mund të ekzekutohet pa përfunduar preprojkti me leje të organit mbikëqyrës dhe raportit të punimeve por pagesa e fundit pa përfunduar në tërësi projekti nuk bëhet.

Sa i përketë Muzeut ne kemi pasur problem me KEDS-in për shkak të projektit të detajizuar të rrjetit të energjisë sepse muzeu ka qenë veç projekt ideor dhe jo i detajuar prandaj KEDS-i ka gabuar njëherë kur e lëshuar rrymën e më pas e ka ndërprerë.

Borxhet e Komunës ne i pasqyrojmë në Ministrinë e Financave edhe i kemi evidencat për këtë. Ka borxhe faktike dhe borxhe kontratuale.

Sa i përketë projektit për shtrimin nga të rrugës nga të dy anët e lumit, trotuarit dhe ndriçimit, shtegut për ciklizëm ja kam sqaruar në zyre Albani që për t'u realizuar ky projekt mund të kushtoj deri 900,000.00€ dhe nuk i kemi këto mundësi.

Hidajete, nëse ne e vendosim për ndërtimin e një rrjeti të kanalizimit ne nuk e vendosim për disa njerëz por për tërë shoqërinë dhe lokalitetin.

Alban Krasniqi: Kërkesat që ne i adresuam këtu, drejtori po i do në formë të shkruar atëherë neve na bie që ti artikulojmë këto kërkesa tona, e nuk po i përsërisë edhe njëherë.

Rrahim Morina: Pas këtij debati kalojmë në pikën e 2-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/11 datë:28.01.2020 të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për miratim të draft-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2020. E hapi debatin për këtë pikë.

Valon Mazreku: Ne e kemi përgatitur këtë Draft-Rregullore duke e modifikuar dhe e mbështetur në udhëzimet administrative nga ministrinë për shërbimet, taksimet, tarifat që kryhen në nivelin lokal por që janë të rregulluara në nivelin qendror. Te administrata nuk ka asnjë ndryshim nga viti i kaluar . tek Drejtoria për Ekonomi dhe Financa ne i kemi propozuar vetëm disa biznese të cialt krijojnë të ardhura më të shumata siç janë: gurthyesit 1,500.00€, prodhimi i tekstit, lëkurës, betonit, asfaltimit ka ndryshime. Te Drejtoria e Shëndetësisë ka ndryshime, tek Urbanizmi nuk ka ndryshime, te Drejtoria e Gjeodezisë i kemi zvogëluar pak gjëra sepse janë të rregulluara me udhëzim administrativ kështu me radhë diku diku i kemi ndryshimet aty në Rregullore.

Kuvendi i Komunës është autoritet i cili mundet të propozojë, ndryshojë sa i përketë kësaj Rregullore dhe ne së bashku do të mundohemi që ta harmonizojmë ashtu siç është më së miri.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë. Këtë sot duhet ta votojmë që ta dërgojmë për dëgjim publik.

Alban Krasniqi: Sipas raportit finaciar për vitin 2019 e pamë që kishte një ngritje të të hyrave vetanake për 5.15% pra kjo rritje është përtej planifikimit. Kjo është shumë pozitive. Në kushte normale kjo nuk do të duhej të ishte diçka e çuditshme.

Sa i përket Rregullores P.sh: tek avokatët, noterët ngarkesa e taksës është 0. A mendoni që 0€ duhet ta ketë taksën noteri? Ky lloj veprimtari ka të hyra të mjaftueshme që nga 20-50€ në vit është tamam për të. Tjetër 0€ është taksa për pompa të benzinës ndërsa berberët taksohen, kjo nuk është fer. Kontrolla teknike për automjete taksën e ka 0€. Kjo është pabarazi dhe e dëmton buxhetin e komunës. Unë nuk jam për këso politikash.

Është mirë që të ulemi të gjithë së bashku dhe t'i shikojmë rend të gjitha veprimtaritë një për një e ta caktojmë për këtë një grup punues. Në këtë Rregullore nuk janë të ngarkura as 50 biznese pra kjo është shumë e paktë. Kjo rregullore kërkoj që të jetë më profesionale dhe për lirim të atyre bizneseve kërkoj nga Kryetari ose drejtori që të vijë me një arsyetim të shkruar që e justifikojnë në aspektin ekonomik, social që ajo përmirëson klimën e të bërit biznes në K. e Malishevës dhe ku janë bazuar, prej cilëve tregues?

Hashim Vrenezi: Sa i përket taksave në KPF kam kërkuar disa çështje që drejtori është dashur që t'i sjellë më heret para se Rregullorja të vie këtu. Një informatë që e mora që bizneset të cilat ushtrojnë veprimtari në K. e Malishevës e që e hyra totale që ka ndodh në vitin 2019 është 9,091.00€. Kjo është një arsye e fuqishme që taksat e bizneseve me i heq krejt për arsye që disa biznese paguajnë e disa jo. Për ata që nuk paguajnë Komuna nuk merr asnjë masë e krijohen kushte të pabarabarta për bizneset prandaj isha që kjo taksë të hiqet.

Jam edhe unë sikur Albani që të krijohet një grup punues e të jemi më parimor në caktimin e taksës për çdo veprimtari e të mos ketë diskriminim edhe për ato që mendojmë që duhet t'i lëjmë.

Arbëreshë Krasniqi: Në këtë çështjen e taksave e kemi diskutuar me Kryetarin e me drejtorët që nga 2013, jo vetëm tani. Bizneset nga taksa komunale janë liruar që nga ajo kohë.

Presenoalisht mendoj që bizneset nuk janë të barabarta sepse një market shumë i vogël nuk mund të krahasohet me një sallë dasmesh apo një ordinacë mjeksore private.

Në si NISMA e kemi pasur këtë premtim elektorial e jo rastësisht e kemi bërë këtë sepse bizneset kanë nevojë që të lirohen nga kjo taksë. Por, për të pasur një barazi sociale mendoj që jo të gjitha bizneset të lirohen nga taksa komunale sepse e përmenda një rast më parë.

Është mirë që të kërkojmë pak kohë për këtë Rregullore dhe ta harmonizojmë detajisht me punë të përbashkët dhe të dalim me një qëndrim unik.

Rrahim Morina: Kjo Rregullore duhet t'i nështrohet dëgjimit publik, prandaj ne ta votojmë, e më pas kemi hapësirë që të gjitha grupet politike mund të koordinohemi e ta harmonizojmë këtë Rregullore.

Kërkoj që sot pavarësisht që ora u bë 16 të shqyrtojmë edhe 2 pika të rendit të ditës për një rregullore tjetër e që ju ka nënshtruar dëgjimit publik, dhe Rporti i Komisionit për Bazi Gjimore. Kush është për që ta dërgojmë për dëgjim publik draft-Rregulloren për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2020?

Për: 15

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me këtë votim kjo Rregullore shkon për dëgjim publik dhe i mbetet Drejtorisë së Financave që të merret me këtë çështje dhe shpresojmë që në fund të muajit mars të vie këtu për miratim.

Kalojmë në pikën e 3-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/24

datë:14.02.2020 të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për miratim të propozim Rregullores për Tatimin në Pronë për vitin 2020. Kjo Rregullore juy ka nënshtruar dëgjimit publik pra e ka bërë leximin e parë, ky është leximi i dytë dhe kërkon aprovim. E hapi debatin për këtë pikë.

Alban Krasniqi: Ne kemi kërkuar nga drejtoria përkatëse që t'na njoftojë për debatin publik nëse është mbajtur, apo nëse ka pasur apo jo pjesëmarrës. Nëse është bërë njoftimi, si është bërë ai? Pse nuk ka qenë asnjë pjesëmarrës në këtë dëgjim publik? Kjo është shqetësuese! Kjo rregullore i prek qytetarët.

Kam kërkuar gjithaashtu që në këtë Rregullore të bëhet ndarja e zonave në mënyrë të qartë dhe ne t'i kemi ato ndarje në formë harte prancaj edhe nuk e di se si të marr vendim për këtë kur ju nuk i keni sjellur informacionet. Unë e kam të drejtën që me dal jashtë dhe ju nuk keni kourrum, por sjellna këto informacione dhe unë nuk po e lëshoj sallën.

Rrahim Morina: Alban me datën 25 ju kam drejtuar me shkrim, por Zyra Pranimit nuk e paska dërguar kërkesën me kohë te drejtori për këtë çështje. Nëse ti do me dal jashtë atëherë votimin e kësaj Rregullore e shtyejmë për mbledhjen tjetër.

Arbëreshë Krasniqi: Alban, kjo është e thjeshtë për ta bërë sepse torikisht e ke të shkruar në Rregullore. Sigurisht që do të ishte më e detajuar sigur të bëhet në mënyrë hartografike kjo ndarja e zonave. Nëse ju kërkon që kjo të behët ne e shijmë për mbledhjen tjetër votimin e kësaj Rregullore dhe e bëjmë këtë.

Rrahim Morina: Atëherë kjo pikë shihet për mbledhjen tjetër dhe obligohet drejtori i Drejtorisë së Financave që t'i sjellë ato që u kërkuan këtu.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës nr.02/19 datë:13.01.2020 të Komitetit për Barazi Gjinore për vitin 2019. Raportin e keni marrë me kohë dhe a shkojmë direkt në votim nëse nuk keni diçka për të diskutuar?

Atëherë kush është pro miratimit të Rportit për vitin 2019 të Komitetit për Barazi Gjinore?

Për: 16 (unanimisht)

Pasi që i kemi pikat për auditorin e mbrendshëm kërkoj sqarimin nga Esat Gashi për çështjet që Kuvendi kërkon raportin e punës.

Esat Gashi: Pershendetje për të gjithë! Me ligjin për kontrollin e mbrendshëm të financave publike, në kapitullin e III-të është e përfshirë edhe çështja e auditimit. Neni 21 thotë: pavarësia funksionale e njësisë së auditimit të brendshëm, pika 1: "njësia e autimit të brendshëm ushtron funksionin e saj në mënyrë të pavarur dhe i raporton drejtpërdrejt vetëm udhëheqësit të subjektit

të sektorit publik dhe e njofton komitetin e auditimit” kjo është ajo pika që nuk na lejon që të raportojmë këtu.

Rrahim Morina: Kërkesë e Kuvendit është që kur ta sillni Planin e Punës duhet që të vie së bashku edhe raporti, përndryshe nuk debatohet Plani i Punës. Për këtë ju drejtohem me shkrim.

Nebih Bibaj: Ne në këtë trajnimin e fundit që kemi qenë nga të gjitha subjektet politike u tash që raporti i auditimit të brendshëm dërgohet në KPF. Nëse ky raport shkon në KPF ajo mund ta dërgojë për Kuvend.

Rrahim Morina: Falemnderit për pjesëmarrje, me kaq mbledhjen e shpalli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora 16:30.

Procesmbajtësja: Samirë Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit: Rrahim Morina
